



AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM
KOSOVO ACCREDITATION AGENCY
AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA

Nr. 64115 Dt. 27.01.2016

Në mbështetje të nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Larte (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen 39-të të mbajtur më 21 janar 2016, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa nr. 478/15, datë 26.10.2015 e BPrAL Kolegji "AAB" për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 1060/15, datë 12.10.2015.
- II. Shfuqizohet vendimi i KSHC-së nr. 1060/15, datë 12.10.2015
- III. Akreditohet programi i studimit:
 - Infermieri, BSc (180 ECTS)
- IV. Akreditimi vlen për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


Arsyetim

Duke u bazuar në nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, kërkesën e BPrAL Kolegji AAB nr.478/15/, datë 26.10.2015 dhe dëshmime te ofruara nga Kolegji AAB për plotësimin e kriterëve sipas kërkesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, dhe raportin final pozitiv të hartuar nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Ndaj këtij vendimi lejohet ankesa sipas nenit 126, pika 2b, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28, datë 22 korrik 2005, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi nga pala.

Vendimi u dërgohet:

- BPrAL Kolegji "AAB";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

